

VENDIM
Nr. 146, datë 24.6.2021

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “TIRANA INTERNATIONAL
DEVELOPMENT” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.6.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr. 95/2 prot., datë 22.6.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Tirana International Development’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 135, datë 7.6.2021, ka miratuar fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Tirana International Development” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE, me shkresën nr. 6/17 prot., datë 8.6.2021, ka bërë publikimin në median e shkruar, në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Tirana International Development” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe në përfundim të afatit të njoftimit (datë 21.6.2021), nuk rezultuan vërejtje apo ankesa nga palët e interesuara.

- Shoqëria, me shkresat nr. 714/1 prot., datë 9.6.2021 dhe nr. 714/2 prot., datë 16.6.2021, ka përcjellë në ERE të gjithë dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Aplikimi i shoqërisë rezulton se plotëson tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”: plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “c”, “d”: plotësuar;
- dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c”: plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Tirana International Development” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti